



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of
Industry, Entrepreneurship and Trade*

**EXPORT FOR
KOSOVO
GROWTH**

**PROJEKTI I KONKURRUESHMËRISË DHE GATISHMËRISË
PËR EKSPORT (CERP)**

PROGRAMI PËR GRANTET E PËRPUTHSHME

THIRRJA PËR PROPOZIME

Qershor 2021



Përmbajtja

SHKURTESA DHE AKRONIME	3
THIRRJA PËR PROPOZIME - PROGRAMI PËR GRANTET E PËRPUTHSHME	4
MADHËSITË E GRANTEVE DHE SHPENZIMET E PRANUESHME.....	6
AKTIVITETI 1 - STANDARDET DHE CERTIFIKIMI I PRODUKTEVE	7
AKTIVITETI 2 –MAKINERITË/PAJISJET	7
AKTIVITETI 3 – PAJISJET PËR ORGANET E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT	7
AKTIVITETI 4 - QASJE NË SHËRBIMET DHE TRAJNIMET PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT	8
AKTIVITETI 5 - PAJISJE TË VOGLA PËR PËRMIRËSIM/AVANCIM DIXHITAL.....	8
DEKLARATË:	9
PARA SE TË APLIKONI ÇKA TË MERRET PARASYSH.....	9
DORËZIMI I APLIKACIONEVE.....	10
INFORMACIONE SHITESË	11



Shkurtesa dhe Akronime

Aplikuesi	Ndërmarrja/Kompania/biznesi/firma apo grup biznesor
SHZHB	Shoqatë - Shërbime për Zhvillim të Biznesit
CERP	Projekti Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport
CITES	Konventa rreth Tregtisë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara
MF	Menaxhimi Financiar
MG	Manuali rreth Granteve
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
PPPG	Paneli i Pavarur për Përzgjedhjen e Granteve
ARBK	Agjencia për Regjistrim të Biznesit në Kosovë
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
M&E	Monitorimi dhe Evaluimi
GP	Grantet e Përputhshme
MGP	Marrëveshja për Grantin e Përputhshëm
PGP	Programi për Grantet e Përputhshme
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MF	Ministria e Financave
MoM	Memorandumi i Mirëkuptimit
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
NJIP	Njësi për Implementimin e Projektit
MOP	Manuali Operacional i Projektit
Projekti	Projekti i Aplikuesit për Programin e Granteve të Përputhshme
AT	Asistencë Teknike
BB	Banka Botërore



Thirrja për propozime - Programi për grantet e përputhshme

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës (MINT) implementon Projektin “Konkurueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport (CERP)”, në vlerë prej 14.3 milionë euro me financim përmes kredisë së butë nga Banka Botërore.

Qëllimi i projektit CERP është të mbështesë certifikimin e produkteve për tregjet e eksportit, të forcojë kapacitetin e ndërmarrjeve të orientuara drejt eksportit dhe të ulë koston e inspektimeve të biznesit. MINT ka themeluar Programin e Granteve të Përputhshme (PGP) dhe ka angazhuar Njësinë për Implementimin e Projektit (NJIP) gjegjësisht (konsorciumin “Prishtina REA& WEglobal”) për të menaxhuar zbatimin e PGP.

Si rezultat i kësaj, Njësia për Implementimin e Projektit (konsorciumi "Prishtina REA & WEglobal") po hapin thirrjen për grante që do të aplikojnë për certifikime të produkteve dhe standarde të nevojshme për eksport, aktivitete të mbështetjes së biznesit për hulumtimin e tregut, dizjan të paketimeve, trajnime profesionale, marketing dhe promovim për rritjen e aftësive të eksportit të NVMM-ve. Aktivitetet shtesë që do të financohen nga MGP përfshijnë makineritë përkatëse të prodhimit, pajisjet për vlerësimet e konformitetit dhe pajisjet ose mjetet e dedikuara posaçërisht për avancimin e infrastrukturës dixhitale.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj thirrjeje është të mbështesë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme me potencial eksporti, duke iu përgjigjur pasojave të pandemisë COVID-19 siç janë përmirësimi i aftësive të tregtisë online, çështjet e vazhdimësisë së biznesit, si dhe avancimin e proceseve dhe teknologjisë. NVMM-të dhe Shoqatat e Bizneseve kanë të drejtë të aplikojnë për grante dhe koston në aplikimin e tyre mund të përfshijnë një ose më shumë nga aktivitetet e listuara më poshtë:

- *Aktiviteti 1 - Standardet dhe certifikimi i produkteve*
- *Aktiviteti 2 –Makineritë/pajisjet*
- *Aktiviteti 3 – Pajisjet për trupat e vlerësimit të konformitetit*
- *Aktiviteti 4 - Qasje në shërbimet dhe trajnimet për zhvillimin e biznesit*
- *Aktiviteti 5 - Pajisje të vogla për përmirësim/avancim dixhital*

Vlerësimi i aplikacioneve për alokimin e fondeve për Programin e Granteve të Përputhshme do të realizohet në përputhje me Manualin e Grantit (MG) të projektit PGP.

Aplikuesit duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme të përshtatshëmrisë për të aplikuar për Programin e Granteve Përputhëse:



- Aplikuesi është subjekt juridik afarist, i inkorporuar sipas Ligjit të aplikueshëm/aktual të Kosovës për Shoqëritë Tregtare, i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe i vendosur në Kosovë;
- Shoqatat e Biznesit të regjistruara në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë;
- NMVM-të në pronësi private ose me shumicë të aseteve/aksioneve në pronësi private;
- Kompanitë eksportuese ose ato me potencial eksporti;
- Çdo aplikacion duhet të plotësojë gjithashtu kërkesat minimale teknike në mënyrë që të merren parasysh për fazën e vlerësimit përfundimtar nga Paneli i Pavarur për Përzgjedhjen e Granteve;
- Aplikuesi duhet të jetë drejtpërdrejtë përgjegjës për realizimin e Projektit dhe të mos veprojë si ndërmjetës;
- Aplikuesi ka për obligim të adresojë çështjet mjedisore në projekt propozim dhe të jetë në përputhje me legjislacionin nacional për mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë procesit të aplikimit, aplikuesve u kërkohet të sigurojnë disa informacione të standardizuara dhe dokumente të detyrueshme për një aplikim për të përmbushur kriteret minimale të kualifikimit. Kërkesa duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme dhe të përmbajë dokumentet e cekura:

- Formulari i aplikimit duhet të plotësohet përmes Platformës Online të Aplikimeve dhe Menaxhimit të Granteve (www.mgpkosovo.net)
Projekt propozimi duhet të përmbajë:
 - (a) Planin e biznesit (mostër) ku përfshihet qëllimi, aktivitetet e projektit, kostoja financiare, koha e realizimit të projektit si dhe struktura organizative të aplikuesit;
 - b) Detajet e planit të buxhetit (mostër), të kostove të vlefshme të projektit - përfshirë aplikimin për mbështetje financiare si dhe bashkëfinancimin.
- CV-të e menaxhmentit (2 CV) dhe CV-në e personit që do të mbikëqyrë projektin
- Deklaratë nën betim, (shkarkohet tek Platforma e Aplikacionit “Menaxhimi i Granteve Online).
- Certifikata e Regjistrimit të Biznesit me të gjitha informacionet përcjellëse në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës; Certifikata e Regjistrimit të Biznesit kërkohet edhe tek rastet ku aplikuesi është shoqatë/Asociacion i biznesit.
- Lista e të punësuarve - nga ATK-ja - për vitin 2021, jo më e vjetër se 30 ditë (duke u bazuar edhe tek kategorizimi i Ndërrmarjeve)
- Dokumenti i Verifikimit Kryerjes së Obligimeve Tatimore (mund të shkarkohet tek www.atk-ks.org)

Ju lutemi vini re: Mosparaqitja e ndonjë prej dokumenteve të listuara më sipër mund të rezultojë në refuzimin e aplikimit dhe propozimi nuk do të merret në konsideratë në lidhje me kriteret e renditura si më poshtë:



Kriteret e vlerësimit:

Aplikacionet do të vlerësohen bazuar në kriteret dhe pikët e mëposhtme (rezultati i përgjithshëm 100 pikë):

- | | |
|---|---------|
| 1. Profili i menaxhmentit dhe performanca e kompanisë | 20 pikë |
| 2. Projekt propozimi | 20 pikë |
| 3. Potenciali i tregut për eksport, përfshirë produktet e reja | 20 pikë |
| 4. Metodologjia e menaxhimit të riskut ¹ | 20 pikë |
| 5. Mënyra e përdorimit të fondeve, buxhetit dhe bashkëfinancimi | 20 pikë |

Shënim: Vetëm aplikacionet që marrin mbi 60 (gjashtëdhjetë) pikë do të merren parasysh për vlerësim nga PGP, me një nivel më të lartë të bashkëfinancimit ose grave sipërmarrëse do t'u jepet përparësi. Gratë sipërmarrëse që do të aplikojnë për PGP do të vlerësohen me 10 pikë shtesë. Sidoqoftë, një aplikim mund të fitojë mbi 60 pikë, por numri i përfituesve do të jetë i kufizuar në varësi të buxhetit në dispozicion.

Madhësitë e granteve dhe shpenzimet e pranueshme

NMVM-të dhe Shoqatat e Biznesieve kanë të drejtë të aplikojnë për grante. Shpenzimet e pranueshme përfshijnë zbatimin e standardeve dhe certifikimet e produkteve, blerjen e makinerive/pajisjeve për prodhimtari, blerjen e pajisjeve për përdorim në vlerësimin e konformitetit, pajisje të vogla për avancim dixhital dhe shërbime të zhvillimit të biznesit (SHZHB) gjegjësisht trajnime grupore. Një NMVM ose Shoqatë Biznesi mund të aplikojë dhe të marrë deri në tre (3) grante, përgjatë gjithë programit të granteve të pëëputshme (MGP), përfshirë thirrjen e parë, që ka qenë e publikuar nën këtë projekt nga ana e Ministrisë. Një aplikacion i vetëm mund të përfshijë disa aktivitete (*certifikimin e produktit, standardet, pajisjet/makineritë për prodhim, pajisjet për trupat e vlerësimit të konformitetit, SHZHB/trajnimin, pajisjet e vogla për avancim dixhital*). Shuma totale e grantit për çdo ndërmarrje për të gjitha aktivitetet nuk duhet të kalojë 100.000 €. Një NMVM ose Shoqatë Biznesi mund të paraqesë vetëm një Aplikim në këtë Thirrje të veçantë për Aplikim, duke marrë parasysh udhëzimet për aplikuesit.

NMVM-të dhe Shoqatat e Biznesit kanë të drejtë të aplikojnë për grante dhe shpenzimet e pranueshme mund të përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:

¹ Procesi i identifikimit, kategorizimit, prioritizimit dhe planifikimit masave për mitigim reeqesh para se ato të bëhen qështje brengësë



Aktiviteti 1 - Standardet dhe certifikimi i produkteve

Implementimi i standardeve dhe certifikimit të produkteve përcaktohen si grante për bashkëfinancimin e kostove për NVMM-të për të marrë standarde ndërkombëtare dhe certifikim të produkteve. Financimi që do të jepet nga PGP mund të mbulojë një maksimum prej 90 përqind të kostove për marrjen e këtyre standardeve dhe certifikimeve, deri në 40,000 €. Minimumi prej 10 përqind i kostos duhet të mbulohet nga aplikuesi. Kostot e pranueshme për t'u financuar nga PGP përfshijnë kostot e certifikimit të produktit (testimi, verifikimi, certifikimi dhe inspektimi) auditimet e cilësisë, zbatimi i standardeve, (për shembull, cilësia, mjedisi, trajnimet, etj.). Ofruesi i këtyre shërbimeve mund të jetë gjithashtu nga një vend tjetër. Deri në 100 përqind të një aplikacioni mund t'i kushtohet vetëm kësaj veprimtarie/aktiviteti.

Aktiviteti 2 –Makineritë/pajisjet

Implementimi i aktiviteteve për Makineritë/pajisjet prodhuese, janë përcaktuar si grante për të bashkëfinancuar kostot e NMVM-ve për blerjen e pajisjeve për prodhim (makineri) në mënyrë që të rrisin aftësitë/gatishmërinë e eksportit, posaçërisht për bizneset e prekura nga COVID-19. Financimi që do të jepet nga PGP mund të mbulojë një maksimum prej 50 përqind të kostos së makinerive/pajisjeve për ndërrmarjet e mesme dhe deri në 70 përqind për ndërrmarjet mikro dhe të vogla, por që shuma e grantit nuk kalon 50,000 €. Deri në 70 përqind e një aplikacioni mund t'i kushtohet kësaj veprimtarie. NMVM-të duhet t'i mbajnë dhe mirëmbajnë pajisjet për një periudhë prej të paktën dy vjetësh dhe kjo do të monitorohet. Nëse pajisjet shiten para fundit të periudhës dy-vjeçare, nga NMVM-të do të kërkohet të kthejë pjesën e grantit që është përdorur për të paguar për pajisjet dhe nuk do të kualifikohet për grante të mëtejshme përputhëse.

Aktiviteti 3 – Pajisjet për organet e vlerësimit të konformitetit

Implementimi i këtij aktiviteti për pajisjet për trupat e vlerësimit të konformitetit, përcaktohet si grant për bashkëfinancimin e kostove për NVMM-të për blerjen e pajisjeve për përdorim në vlerësimin e konformitetit, të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë dhe indirekt kontribuojnë në vlerësimin e konformitetit të produkteve të Kosovës para se të hyjnë në tregjet e brendshme dhe të jashtme. Financimi që do të jepet nga PGP mund të mbulojë një maksimum prej 50 përqind të kostos së pajisjeve, për ndërrmarjet e mesme dhe 70 përqind për mikro dhe ndërrmarjet e vogla, për sa kohë që shuma e grantit nuk e kalon 50,000 €, siç detajohet në tabelë e manualit. Deri në 70 përqind e një aplikacioni mund t'i kushtohet kësaj veprimtarie. NMVM-të duhet të mbajnë dhe mirëmbajnë pajisjet për një periudhë prej të paktën



dy vjetësh dhe kjo do të monitorohet. Nëse pajisjet shiten para fundit të periudhës dy-vjeçare, nga NVMV-ja do të kërkohet të kthejë pjesën e grantit që është përdorur për të paguar pajisjet dhe nuk do të kualifikohet për grante të mëtejshme përputhëse.

Aktiviteti 4 - Qasje në shërbimet dhe trajnimet për zhvillimin e biznesit

PGP mund të mbulojë me një maksimum prej 90 përqind të kostos së trajnimeve deri në 10.000 € për një aplikim të vetëm nga një NMVM, ose deri në 25.000 € maksimum për një aplikim nga një Odë shoqatë/asociacion biznesi (SHZHB). Trajnime grupore ose trajnime të realizuara përmes Odave/Shoqatave të Biznesit, do të financohet deri në një maksimum prej 25.000 €, deri në një vit aktivitete. Odat/shoqatat e biznesit gjithashtu mund të kontraktohen për të ofruar trajnime specifike për ndërrmarjet (të paktën tre ndërrmarje si anëtarë të tyre) ose për të siguruar bashkëpunime me kompanitë ndërkombëtare. Kostot e pranueshme për t'u financuar përfshijnë konsulencë për nevoja të ndryshme të biznesit, të tilla si marketing, mirëmbajtje të makinerive (pranimi teknik, mbikëqyrje), zhvillimi i planit të biznesit, menaxhimi financiar dhe përmirësimi i aftësive të punëtorëve tek NMVM-të (p.sh. kostot për financimin e trajnimeve për stafin). Në rastet kur shërbimet e trajnimit dhe konsulencat nuk janë në dispozicion në tregun e brendshëm, opsionet e angazhimit të kompanive ndërkombëtare duhet të paraqiten në planin e biznesit.

Për më tepër, këto kosto të pranueshme janë zgjeruar si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, e cila po dëmton në mënyrë disproporcionale NMVM-të dhe për shkak të rënies së kërkesës globale dhe ndërrmarjeve eksportuese. Andaj, grantet e përputhshme do të vazhdojnë të adresojnë nevojat e investimeve me synimin që të ndihmojnë ndërrmarjet të kthehen në nivelin e prodhimit para-krizës dhe nivelet e punësimit të arrijnë bazat për rritjen e produktivitetit afatgjatë dhe të përgatiten për krizat e ardhshme. PGP do të mbështesë bizneset për të siguruar aktivitete që lehtësojnë qasjen në njohuri për fushat kritike për t'u përgjigjur pandemisë COVID-19 siç janë angazhimi i ofruesve të shërbimeve për të ndërtuar ose përmirësuar aftësitë e tregtisë online, të zhvillojë plane të vazhdimësisë së biznesit në rast të një krize tjetër, të ndihmojë/diversifikoj tregjet e furnitorëve dhe klientëve dhe trajnojnë punonjësit për aftësime të nevojshme për module të reja të të bërit biznes. Për më tepër Odat/shoqatat, që mund të mbështesin proceset dhe avancimin teknologjik, do të jenë gjithashtu si aktivitete të pranueshme. Deri në 100 përqind, një aplikacion i tillë mund të i kushtohet këtij aktiviteti.

Aktiviteti 5 - Pajisje të vogla për përmirësim/avancim dixhital

PGP mund të mbulojë një maksimum prej 70 përqind të kostos së pajisjeve të vogla për përmirësimin/avancimin dixhital, deri në 5,000 €. Pajisjet e vogla për avancim dixhital duhet të



kontribuojnë në përmirësimin e produktit/shërbimit të NMVM-ve, krijimin e një produkti/shërbimi të ri ose përmirësimin e procesit të prodhimit në kontekstin e Projektit të miratuar. Pajisjet e nevojshme për të komplementuar ZSHSB/planet e trajnimit, për t'iu përgjigjur krizës COVID-19, do të jenë gjithashtu të pranueshme. Blerjet e pajisjeve të pranueshme mund të përfshijnë makineri të vogla, softuer, sisteme kompjuterike e vegla/ mjete tjera teknologjike/informatike. Automjetet nuk konsiderohen si shpenzime të pranueshme. Kostot në lidhje me rinovimet, pajisjet tashmë të blera, mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve dhe për pajisjet që nuk janë të rëndësishme për qëllimet e Projektit, nuk janë shpenzime të pranueshme. NMVM-të duhet të mbajnë dhe mirëmbajnë pajisjet për një periudhë prej të paktën dy vjetësh dhe kjo do të monitorohet. Nëse pajisjet shiten para fundit të periudhës dy-vjeçare, nga NVMM-të, do të kërkohet të kthejë pjesën e grantit që është përdorur për të paguar për pajisjet dhe nuk do të kualifikohet për grante të mëtejshme përputhëse. Deri në 70 për qind e një aplikacioni mund t'i kushtohet kësaj veprimtarie.

Deklaratë:

- ***Asnjë automjet nuk do të përfshihet dhe as nuk konsiderohet investim i pranueshëm në këtë aktivitet ose ndonjë aktivitet tjetër të Programit të Grantëve të Përputhshme.***
- Në asnjë nga rastet, kostot në lidhje me rinovimet, pajisjet tashmë të blera, mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve, ose blerja e pajisjeve që nuk janë të rëndësishme për qëllimet e MGP-së, nuk do të konsiderohen si të pranueshme.
- Aplikuesit e mundshëm duhet të kenë parasysh se në rast se përzgjidhen për t'u financuar nga PGP-ja, çdo pajisje e blerë nga projekti dhe prova mbi aktivitetet e realizuara të projektit do të mbahen dhe mirëmbahen në vendin e kontraktuar të projektit për një periudhë prej **të paktën dy vjet dhe do të mbetet në dispozicion gjatë së njëjtës periudhë për qëllimet e monitorimit nga stafi i PGP.** Në rast se këto shënime nuk respektohen nga një përfitues i grantit, e njëjta do të jetë çështje/lëndë i rimbursimit të fondeve të përdorura për projektin e dhënë dhe do të kufizohet për të marrë pjesë në grante të tjera të përputhshme.

Para se të aplikoni çka të merret parasysh

Gjatë përgatitjes së aplikimit, aplikuesit duhet të marrin në konsideratë pikat si në vijim:

Aplikuesi mund të paraqesë një aplikacion të vetëm që mund të përfshijë disa aktivitete (certifikimin e produktit, standardet, pajisjet/makineritë, pajisjet për vlerësimin e konformitetit, BDS/trajnimet, pajisjet e vogla për avansim dixhital). Të gjitha informatat dhe dokumentet duhet të shkruhen dhe dorëzohen në cilëndo nga gjuhët zyrtare të parapara me kushtetutën e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

ose në anglisht. **Sidoqoftë, aplikantëve fuqimisht u rekomandohet të paraqesin aplikacionet e tyre në Anglisht. Dorëzimi i aplikacionit në gjuhë të tjera mund të marrë më shumë kohë në procesin e vlerësimit.**

Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikimet duhet të dorëzohen VETËM përmes Platformës Online të Aplikimit dhe Menaxhimit të Granteve në: www.mgpkosovo.net

Udhëzimet si duhet përdorur Platformën e Aplikimit dhe Menaxhimit të Granteve Online, mund të gjenden në vegzën/linkun vijues: www.mgpkosovo.net **si dhe në website-in e MINT (<https://mint.rks-gov.net/>)**

Vetëm Aplikimet e përfunduara do të pranohen për vlerësim. Afatet janë absolutisht të prera dhe asnjë proces aplikimi nuk do të jetë i disponueshëm pas përfundimit të afatit.

Përgjegjësi e aplikuesit është të sigurojë dorëzimin me kohë të të gjitha informacioneve/dokumenteve. Aplikimet e paraqitura pas afatit nuk do të merren parasysh për vlerësim.

*Afati i fundit për procesin e aplikimit është **28 korrik 2021, 16:00h***

Gjatë procesit të vlerësimit të aplikacionit të pranuar, nga një Aplikues mund të kërkohet të sigurojë/ofrojë informacione ose dokumente shtesë, por gjithashtu mund t'i nënshtrohet një vizite të organizuar në vend të ngjarjes nga Njësia Zbatuese e Granteve.

Në raste kur bëhet një aprovim i grantit, përfituesit i kërkohet që të sigurojnë Njësinë Zbatuese të Granteve, informacione të caktuara të standardizuara në raportet tremujore për të ndihmuar Njësitin për Realizimin e Granteve, të monitorojnë progresin në realizimin e Projektit, përfshirë shpenzimet.



Informacione shitesë

Njësa Implementuese për Programin e Granteve të Përputhshme do të organizojë sesion informues për të siguruar më tej detaje mbi procesin e aplikimit dhe informacione të tjera të rëndësishme për palët e interesuara. Datat indikative të sesioneve janë:

Regjioni	Data/Vendi
Prishtina –Eventi i Lansimiy	29 Qershor 2021 / _____
Info Session – gjeneral	Korrik 2021 / _____

Informacione dhe sqarime shitesë mund të merren përmes postës elektronike: info@mgpkosovo.net jo më vonë se **19 korrik 2021**

Programi i Granteve të Përputhshme diskualifikon aplikuesit për aktivitetet e mëposhtme:

- Degë apo njësitë (ku shumica e aksioneve janë në pronësi të plotë aksionare) e një ndërmarrjeje më të madhe;
- Tregtimi i kafshëve të egra dhe produkteve kafshëve të egra
- Prodhimi, shpërndarja dhe shitja e pesticideve dhe herbicideve të ndaluara
- Peshkimi me rrjet në mjedise ujore
- Prodhimi, trajtimi dhe asgjësimi i produkteve radioaktive
- Konservimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme
- Prodhimi i produkteve që përmbajnë asbest
- Reaktorët bërthamorë dhe pjesët e tyre
- Duhani i papërpunuar ose i përpunuar, përfshirë makineritë
- Prodhimi i armëve të zjarrit
- Alkool i distiluar për konsum

Sqarim shitesë:

- ✓ Kohëzgjatja e projektit nuk duhet të kalojë 12 muaj, përveç nëse është rënë dakord ndryshe në marrëveshjen e nënshkruar midis palëve.
- ✓ TVSH-ja është një shpenzim i papranueshëm për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së.
- ✓ MSME ose Shoqata e Biznesit mund të aplikojë për çdo numër të thirrjeve të publikuara për aplikime dhe mund të marrë / fitojë deri në maksimum 100,000 € për aplikim duke u



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

bazuar në udhëzimet dhe sqarimet e dhëna brenda udhëzuesit përkatës për Aplikuesit e MGP të qershorit 2021.

Periudha e aplikimit:

Njoftimi për thirrjen publike është publikuar në uebfaqen e Njesisë Implementuese të Programit të Granteve të Përputhshme www.mgpkosovo.net, webfaqen e MINT (<https://mint.rks-gov.net/>) në webfaqen e Prishtina REA www.prishtina-rea.net dhe portalet e njoftimeve për grante dhe tenderë si dhe faqet mediatike të Programit. Të gjithë ata që dëshirojnë të aplikojnë nën thirrjen publike duhet të shprehin interesin e tyre duke dorëzuar aplikacione përmes Platformës së Aplikimeve dhe Menaxhimit të Granteve Online www.mgpkosovo.net

Afati i fundit për aplikim is *28 korrik 2021*

Informacione dhe sqarime shtesë mund të merren përmes Platformës Online të Aplikimeve dhe Menaxhimit të Granteve në www.mgpkosovo.net ose përmes postës elektronike në info@mgpkosovo.net më së voni 10 ditë para se të mbyllet faza e aplikimit - ose para dates **19 korrik 2021**. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në Platformën e Aplikimeve dhe Menaxhimit të Granteve Online më së voni deri **23 korrik 2021**.